

## KONVENTA

### PËR

# TË DREJTËN E PUBLIKUT PËR INFORMACION, PJESËMARRJE NË VENDIM MARRJE DHE TË DREJTËN PËR T'IU DREJTUAR GJYKATËS, PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME MJEDISIN

Århus, Danimarkë

25 qershor 1998

*Palët në këtë Konventë,*

Duke patur parasysh parimin 1 të Deklaratës së Stokholmit mbi Mjedisin Human Njerëzor,

Duke patur parasysh parimin 10 të Deklaratës së Rio-s mbi Mjedisin dhe Zhvillimin

Duke patur parasysh më tej Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 37/7 të 28 Tetor 1982 në lidhje me Kartën Botërore për Natyrën dhe 45/94 të 14 Dhjetor 1990, mbi nevojën e sigurimit të një mjedisi të shëndetshëm për mirëqënien e individëve,

Duke patur parasysh Kartën Evropiane mbi Mjedisin dhe Shëndetin, të miratuar në Konferencën e Parë Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Frankfurt, Gjermani, më 8 dhjetor 1989,

Duke pohuar nevojën për të mbrojtur, ruajtur dhe përmirësuar gjendjen e mjedisit dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe në harmoni me mjedisin,

Duke pranuar që mbrojtja e duhur e mjedisit është thelbësore për mirëqënien e njerëzve dhe ushtrimin e të drejtave bazë njerëzore, duke përfshirë vetë të drejtën për të jetuar,

Duke pranuar që çdo person ka të drejtë të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe detyrën si individ dhe në shoqëri, që të mbrojë dhe përmirësojë mjedisin për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm,

Duke marrë parasysh se, në mënyrë që të jetë e mundur që qytetarët të mbrojnë këtë të drejtë dhe të respektojnë këtë detyrë, ata duhet të informohen për mjedisin, të lejohen të marrin pjesë në marrjen e vendimeve për mjedisin, të kenë të drejtë për t'iu drejtuar gjykatës dhe duke pranuar se në lidhje me sa më sipër, qytetarëve mund t'u nevojitet ndihmë për të ushtruar të drejtat e tyre,

Duke pranuar që, në fushën e mjedisit, përmirësimi i të drejtës për informacion dhe pjesëmarrjes publike në vendim marrje nxit rritjen e cilësisë dhe zbatimin e vendimeve, kontribuon në ndërgjegjësimin e publikut për problemet e mjedisit, i jep publikut mundësitë për të shprehur shqetësimet e tij dhe i detyron autoritetet publike për t'i marrë ato në konsideratë,

Duke synuar thellimin e përgjegjësisë dhe transparencës në procesin e vendim marrjes dhe fuqizimin e mbështetjes publike për vendimet për mjedisin,

Duke pranuar dëshirën për transparencë në të gjitha sektorët e qeverisë duke ftuar edhe organet ligjvënëse, në zbatimin e parimeve të kësaj Konvente në procedurat e tyre,

Duke pranuar gjithashtu që publiku ka nevojë të jetë i ndërgjegjshëm për procedurat e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve për mjedisin, të ushtrojë lirisht të drejtën e pjesëmarrjes dhe të dijë si t'i përdorë ato.

Duke pranuar më tej rolet e rëndësishme që mund të luajnë përkatësisht qytetarët, organizatat joqeveritare dhe sektori privat për mbrojtjen e mjedisit,

Duke dëshiruar që të promovohet edukimi mjedisor për të thelluar kuptimin e mjedisit e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të inkurajuar rritjen e ndërgjegjësimin të publikut, pjesëmarrjen e tij në vendimet që ndikojnë mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm,

Duke parë në këtë kontekst, rëndësinë e përdorimit të medias, formave elektronike ose formave të tjera të komunikimit, si edhe formave të ardhshme të komunikimit,

Duke pranuar rëndësinë e integritit të plotë të konsideratave mjedisore në vendim marrjen e qeverisë dhe nevojën që kanë për pasojë autoritetet publike, për të poseduar informacion të saktë, të gjithanshëm dhe bashkëkohor për mjedisin,

Duke pranuar që autoritetet publike e posedojnë informacionin mjedisor në interes të publikut,

Duke dashur që institucionet e edukimit të inkurajojnë kuptimin e mëtejshëm të mjedisit dhe zhvillimit, veçanërisht nga fëmijët, për shembull duke siguruar programe të veçanta dhe trainime për tema të tilla dhe duke inkurajuar ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen në vendime që ndikojnë mjedisin dhe zhvillimin,

Të shqetësuar që mekanizmat juridikë efektive të jenë të hapur për publikun, duke përfshirë edhe organizatat, në mënyrë që interesat e tyre legjitime të mbrohen dhe ligji të zbatohet,

Duke parë rëndësinë e dhënies së informacionit të duhur mbi produktet për konsumatorët, me qëllim që ata të aftësohen për të kryer zgjedhje të informuara mjedisore,

Duke pranuar shqetësimin e publikut për çlirimin e qëllimshëm të organizmave të modifikuara gjenetikisht në mjedis dhe nevojën për rritjen e transparencës dhe pjesëmarrje më të madhe të publikut në vendim marrjen në këtë fushë,

Të bindur që zbatimi i kësaj Konvente do të kontribojë në forcimin e demokracisë në rajonin e Komisionit Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UN/ECE),

Të vetëdijshëm për rolin e luajtur në këtë kuadër, nga ECE dhe duke sjellë në mend, midis të tjerash, Udhëzimet e Komisionit Ekonomik për Evropën, për të Drejtën për Informacion

Mjedisor dhe Pjesëmarrjen Publike në marrjen e Vendimeve Mjedisore, miratuar nga Deklarata e Ministrave, e adoptuar në Konferencën e Tretë Ministeriale "Mjedisi për Europën", në Sofje, Bullgari, më 25 Tetor 1995,

Duke patur parasysh klauzolat përkatëse të Konventës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në një Kontekst Ndërkufitar, të nënshkruar në Espoo, Finlandë në 25 shkurt 1991, dhe të Konventës për Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale dhe asaj për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqenet Ndërkombëtare të nënshkruara së bashku në Helsinki, më 17 mars 1992, si edhe konventa të tjera rajonale,

Të vetëdijshëm që miratimi i kësaj Konvente do të ketë kontribuar në fuqizimin e mëtejshëm të procesit "Mjedisi për Europën" dhe në rezultatet e Konferencës së Katërt të Ministrave në Århus, Danimarkë, në Qershor 1998,

**Kanë rënë dakort si vijon:**

## **Neni 1**

### **Objektivi**

Me qëllim që të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij, çdo Palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

## **Neni 2**

### **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj Konvente,

1. "Palë" nënkupton, me përjashtim të rasteve kur thuhet ndryshe në tekst, një Palë Kontraktuese të kësaj Konvente;
2. "Autoritet publik" nënkupton:
  - (a) Qeverinë në nivel kombëtar, rajonal, dhe nivel tjetër
  - (b) Personat fizikë ose juridikë që kryejnë funksione publike administrative, sipas ligjit kombëtar, duke përfshirë dhe detyra, aktivitete ose shërbime të veçanta në lidhje me mjedisin
  - (c) Çdo person tjetër fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose funksione publike, ose që ofron shërbime publike, në lidhje me mjedisin, nën kontrollin e një organi ose personi, i cili përfshihet në nënparagrafet (a) ose (b):
  - (d) Institucionet e çdo organizate rajonale të integritit ekonomik, referuar në nenin 17, e cila është palë në këtë Konventë;

Ky përkufizim nuk përfshin organet ose institucionet, që veprojnë në kapacitet gjykes ose legjislativ.

3. "*Informacion Mjedisor*" nënkupton çdo informacion me shkrim, vizual, gojor, elektronik ose çdo lloj forme tjetër material mbi:

(a) Gjendjen e elementeve të mjedisit, të tilla si, ajri e atmosfera, uji, toka, pejsazhi e shumëllojshmëria biologjike dhe komponentët e tij, duke përfshirë organizmat e modifikuar gjenetike dhe ndërveprimin midis këtyre elementeve.

(b) Faktorë, të tillë si substancat, energjia, zhurmat e rrezatimi, dhe aktivitetet ose masat, përfshirë masat administrative, marrëveshjet mjedisore, politikat, legjislacionin, planet dhe programet, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë elementet e mjedisit, brenda fushës së nënparagrafit (a) më lart, kostot-përfitimet dhe analizat e tjera ekonomike, si edhe supozimet e përdorura në vendim marrjen mjedisore;

(c) Gjendjen e shëndetit të njeriut dhe sigurisë së tij, kushtet e jetës njerëzore, vendet kulturore dhe strukturat e ndërtuara nga njeriu, në shkallën në të cilën ato ndikohen ose mund të ndikohen nga gjendja e elementëve të mjedisit, ose përmes këtyre elementëve, nga faktorët, aktivitetet, ose masat të referuara në nënparagrafin (b), më sipër;

4. "*Publiku*" nënkupton një ose shumë persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikat kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre;

5. "*Publiku i interesuar*" nënkupton publikun e ndikuar ose që mund të ndikohet, apo që është i interesuar për vendim marrjen mjedisore; për qëllimet e këtij përkufizimi, shoqatat joqeveritare që promovojnë më tej mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat e vëna në ligjet kombëtare, do të konsiderohen të interesuara.

### **Neni 3**

#### **Klauzola të përgjithshme**

1. Çdo Palë do të marrë masat e nevojshme legjislative, rregullatore dhe masa të tjera, duke përfshirë masat për të arritur një përputhje midis klauzolave që zbatojnë kushtet e të drejtës së informimit, pjesëmarrjes dhe të drejtës për t'ju drejtuar gjykatës në këtë Konventë, si dhe masat e duhura të zbatimit rigoroz për të krijuar dhe ruajtur një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm për zbatimin e klauzolave të kësaj Konvente.

2. Çdo Palë do të përpiqet të sigurojë që zyrtarët dhe autoritetet ndihmojnë dhe udhëheqin publikun, kur kërkojnë të informohen për mjedisin, kur kërkojnë lehtësimin e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve mjedisore dhe kur kërkojnë t'i drejtohen gjykatës për çështjet e mjedisit.

3. Çdo Palë do të promovojë edukimin mjedisor dhe rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut, veçanërisht për mënyrën e marrjes së informacionit për mjedisin, të marrjes pjesë në vendim marrjen dhe të ushtrimit të së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës.

4. Çdo Palë do të parashikojë masa për njohjen e duhur dhe mbështetjen e shoqatave, organizatave, ose grupeve që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe do të sigurojë që sistemi i vet ligjor kombëtar, të jetë në përputhje me këtë detyrim.

5. Klauzolat e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë të drejtën e një Palë për të ruajtur ose prezantuar masat që parashikojnë të drejta më të zgjeruara për informacion, hapësirë më të gjërë për pjesëmarrjen publike në marrjen e vendimeve mjedisore dhe më tepër të drejta për t'ju drejtuar gjykatës, se sa ato që kërkohen në këtë Konventë.

6. Kjo Konventë nuk do të kërkojë pakësimin/ dobësimin e të drejtave ekzistuese të publikut për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë vendim marrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.

7. Çdo Palë do të promovojë zbatimin e parimeve të kësaj Konvente në proceset ndërkombëtare të vendim marrjes për mjedisin dhe brenda kuadrit të organizatave ndërkombëtare në çështjet që lidhen me mjedisin.

8. Çdo Palë do të sigurojë që personat të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente nuk do të gjykojnë, persekutohen, ose ngacmohen në çfarë do mënyre për përfshirjen e tyre. Kjo klauzolë nuk do të ndikojë autoritetin e gjykatave kombëtare në dhënien e kostove të arësyeshme gjatë procedurave gjyqësore.

9. Brenda sferës së klauzolave përkatëse të kësaj Konvente, publiku do të ketë të drejtën për të pasur informacion, do të ketë mundësinë për të marrë pjesë në vendim marrje dhe do të ketë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, pa u diskriminuar, për sa i përket nënshtetësisë, kombësisë, vendbanimit dhe në rastin e një personi juridik, pa u diskriminuar për shkak të vendit të tij të regjistrimit ose të qendrës efektive të aktiviteteve të tij.

#### **Neni 4**

### **E DREJTA PËR TË PATUR INFORMACION MJEDISOR**

1. Çdo Palë do të sigurojë që, në përputhje me paragrafet e mëposhtëm të këtij Neni, autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacion mjedisor, ta bëjnë informacionin të disponueshëm, brenda kuadrit të ligjit kombëtar, përfshirë kopje të dokumentit aktual që përmban këtë informacion, në rastet kur kërkohet dhe sipas nënparagrafit (b) më poshtë:

(a) Pa qënë nevoja për të deklaruar interesin për këtë informacion

(b) Në formën e kërkuar në qoftë se:

(i) Nuk është e arsyeshme për autoritetet publike që ta bëjnë atë të disponueshëm në një formë tjetër, dhe në këtë rast ato do të japin arsyet përse e kanë bërë të disponueshëm në atë formë; ose

(ii) Informacioni nuk është ndërkohë i disponueshëm për publikun në një formë tjetër;

2. Informacioni mjedisor, referuar në paragrafin 1 më lart, do të bëhet i disponueshëm sa më shpejt që të jetë i mundur, por jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës, nëse volumi dhe kompleksiteti i informacionit e justifikon zgjatjen e kësaj periudhe deri në dy muaj mbas

kërkesës. Kërkesi i informacionit do të informohet për çdo shtyrje të afatit kohor dhe për arsyet që justifikojnë këtë shtyrje.

3. Një kërkesë për informacion mjedisor mund të refuzohet në qoftë se:

- (a) Autoriteti publik, të cilit i adresohet kërkesa, nuk e ka informacionin mjedisor të kërkuar;
- (b) Kërkesa është paraqitur në mënyrë tepër të paarsyeshme ose është formuluar në një mënyrë shumë të përgjithshme;
- (c) Kërkesa ka të bëjë me një material që është në përfundim ose ka të bëjë me komunikimin e brendshëm të autoriteteve publike, në rast se një përjashtim i tillë parashikohet në ligjin ose në praktikat e përditshme kombëtare, duke marrë parasysh që dhënia e informacionit i shërben interesit publik.

4. Një kërkesë për informacion mjedisor mund të refuzohet në qoftë se dhënia e tij mund të ndikojë negativisht:

- (a) Konfidencialitetin e procedurave të autoriteteve publike, kur një konfidencialitet i tillë parashikohet nga ligji kombëtar;
- (b) Marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare ose sigurimin publik;
- (c) Mënyrën e gjyqimit, aftësinë e një personi për të patur një gjyq të ndershëm ose aftësinë e një autoriteti publik për të kryer një hetim të një natyre disiplinore ose kriminale;
- (d) Konfidencialitetin e informacionit tregtar dhe industrial, në rast se një konfidencialitet i tillë mbrohet me ligj, me qëllim që të mbrohet një interes legjitim ekonomik. Brenda këtij kuadri, do të jepet informacioni për shkarkimet, i cili lidhet me mbrojtjen e mjedisit;
- (e) Të drejtat për pronën intelektuale;
- (f) Konfidencialitetin e të dhënave personale dhe/ose dosjeve që kanë lidhje me një person fizik, kur ky person nuk ka dhënë pëlqimin e tij për dhënien e informacionit për publikun, kur një konfidencialitet i tillë parashikohet në ligjin kombëtar;
- (g) Interesat e një pale të tretë e cila e ka dhënë informacionin e kërkuar, por pa qënë e aftë ose pa qënë e detyruar nga ana ligjore për ta bërë këtë, dhe ku ajo Palë nuk ka dhënë pëlqimin e saj për dhënien e këtij materiali; ose
- (h) Mjedisin, me të cilën lidhet informacioni, siç është folenizimi i specieve të rralla.

*Arsyet e sipërpërmendura për refuzim do të interpretohen në një mënyrë të kufizuar, duke patur parasysh që dhënia e informacionit t'i shërbejë interesit të publikut dhe duke patur parasysh gjithashtu, nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis.*

5. Kur autoriteti publik nuk e ka informacionin e kërkuar mjedisor, ai duhet, sa më shpejt që të jetë e mundur, të informojë kërkesin për autoritetin publik, tek i cili ai beson se është e mundur të kërkohet informacioni që dëshiron, ose ta transferojë kërkesën e tij të ky autoritet dhe të informojë për këtë kërkesin.

6. Çdo Palë do të sigurojë që, nëse informacioni i përjashtuar për dhënie, në paragrafet 3 (c) dhe 4 më sipër, mund të ndahet pa dëmtuar konfidencialitetin e informacionit të përjashtuar për t'u dhënë, autoritetet publike ta bëjnë të disponueshëm informacionin e mbetur mjedisor, i cili kërkohet.

7. Një refuzim i një kërkesë do të jepet me shkrim, nëse kërkesa ishte me shkrim ose nëse kërkuesi e dëshiron të tillë. Refuzimi do të pohojë arsyet për refuzimin dhe do të japë informacion për procedurat të rishqyrtimit, parashikuar në përputhje me nenin 9. Refuzimi duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe jo më vonë se brenda një muaji, nëse kompleksiteti i informacionit nuk justifikon një kohëzgjatje deri në dy muaj pas kërkesës. Kërkuesi duhet të informohet për çdo kohëzgjatje dhe për arsyet që e justifikojnë atë.

8. Çdo Palë mund të lejojë autoritetet e saj publike të vendosin pagesat për dhënien e informacionit, por këto pagesa nuk duhet të tejkalojnë një shumë të arsyeshme. Autoritetet publike, të cilat synojnë të vendosin pagesa të tilla për informacionin që servirin, duhet t'u vënë në dispozicion, kërkuessve të informacionit, një listë të këtyre pagesave, të cilat mund të mblidhen, duke treguar rrethanat në të cilat ato mund të mblidhen ose jo (hiqet dorë), si edhe rastet kur dhënia e informacionit kushtëzohet prej pagimit paraprak të një pagese të tillë.

## **Neni 5**

### **MBLEDHJA DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT MJEDISOR**

1. Çdo palë duhet të sigurojë:

- (a) Që autoritetet publike të zotërojnë dhe të rinovojnë informacionin mjedisor, i cili lidhet me funksionet e tyre;
- (b) Krijimin e sistemeve detyruese për të siguruar një rrjedhje të përshtatshme të informacionit për mjedisin, për tek autoritetet publike, në lidhje me aktivitete të propozuara dhe atyre ekzistuese, të cilat mund të ndikojnë dukshëm mjedisin;
- (c) Në rast të ndonjë kërcënimi të rëndësishëm të shëndetit të njeriut ose mjedisit, shkaktuar nga aktivitetet e njerëzve apo shkaqe natyrore, i gjithë informacioni i cili mund të ndihmojë publikun të marrë masa për të parandaluar ose zbutur dëmin që rrjedh nga ky kërcënim, dhe i cili zotërohet nga një autoritet publik t'u shpërndahet menjëherë dhe pa vonesë anëtarëve të publikut të cilët mund të jenë ndikuar.

2. Çdo Palë do të sigurojë që, brenda kuadrit të legjislacionit dhe praktikave kombëtare, mënyra në të cilën autoritetet publike e bëjnë informacionin mjedisor të disponueshëm për publikun, të jetë transparente dhe e drejta për ta patur atë të ushtrohet efektivisht, midis të tjerave,

- (a) Duke i dhënë informacion të mjaftueshëm publikut, për llojin dhe sferën e informacionit mjedisor, të zotëruar nga autoritetet përkatëse publike, kushtet bazë në të cilat një informacion i tillë bëhet i disponueshëm, dhe për procesin me anë të të cilit, ky informacion mund të sigurohet;

(b) Duke krijuar apo ruajtur praktika të tilla si:

- (i) Disponimi i listave, regjistrave ose dosje informative për publikun;

(ii) Kërkesa që zyrtaret të mbështesin publikun, në kërkim të së drejtës për informacion sipas kësaj konvente; dhe

(iii) Identifikimi i pikave të kontaktit;

(c) Duke dhënë pa pagesë informacionin që përmbajnë listat, regjistrat ose dosjet sipas nënparagrafit (b-i) me lart.

3. Çdo Palë duhet të sigurojë që informacioni mjedisor, të bëhet në mënyrë progresive i disponueshëm në database elektronike, në të cilat hyhet lehtësisht nga publiku, nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimit. Informacioni në këtë formë duhet të përfshijë:

(a) Raportet mbi gjendjen e mjedisit, referuar në paragrafin 4 më poshtë;

(b) Tekstet e legjislacionit mbi mjedisin ose të lidhura me të;

(c) Kur shihet e përshtatshme, politikat, planet dhe programet për ose të lidhura me mjedisin, dhe marrëveshjet mjedisore dhe

(d) Informacion tjetër, në shkallën që disponimi i një informacioni të tillë në këtë formë, do të lehtësojë aplikimin e ligjit kombëtar, në zbatim të kësaj Konvente,

*duke parashikuar që, një informacion i tillë është ndërkohë i disponueshëm në formë elektronike.*

4. Çdo Palë duhet, që në intervale të rregullta pa kaluar tre ose katër vjet, të publikojë dhe shpërndajë një raport kombëtar mbi gjendjen e mjedisit, duke përfshirë informacionin mbi cilësinë e mjedisit dhe informacione për presionet mbi mjedisin.

5. Çdo Palë duhet të marrë masa, brenda kuadrit të legjislacionit të saj, me synim shpërndarjen, midis të tjerash, të:

(a) Dokumentave të legjislacionit dhe politikës, si dhe dokumentave mbi strategjitë, politikat, programet dhe planet e veprimit, të cilat janë të lidhura me mjedisin, dhe raporteve mbi zbatimin e tyre, të përgatitura në nivele të ndryshme të administratës publike;

(b) Traktateve, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi çështjet e mjedisit; dhe

(c) Dokumentave të tjera të rëndësishme ndërkombëtare mbi çështjet e mjedisit, kur shihet e përshtatshme.

6. Çdo Palë do të inkurajojë zhvilluesit, aktiviteti i të cilëve ka një ndikim të dukshëm mbi mjedis, të informojnë publikun rregullisht mbi ndikimet mjedisore të aktiviteteve dhe prodhimeve të tyre, atje ku shihet e përshtatshme dhe brenda kuadrit të skemave vullnetare të etikimit ose revizionimit mjedisor, apo mjeteve të tjera.

7. Çdo Palë do të:



- (a) publikojë fakte dhe analizat e tyre, të cilat i konsideron të vlefshme dhe të rëndësishme në formulimin e propozimeve të politikave mjedisore kryesore;
- (b) publikojë, ose t'i bëjë të disponueshme për publikun materiale shpjeguese për marrëdhëniet me publikun, në çështjet që lidhen me veprimtarinë e kësaj Konvente; dhe
- (c) ofrojë, në një formë të përshtatshme, informacionin për kryerjen e funksioneve publike ose sigurimin e shërbimeve publike, që lidhen me mjedisin, nga qeveria në të gjitha nivelet.
8. Çdo Palë do të zhvillojë mekanizmat me synimin për të siguruar që produkte të mjaftueshme informative të bëhet i disponueshëm për publikun në mënyrë që t'i aftësojë konsumatorët që të bëjnë zgjedhje të informuara mjedisore.
9. Çdo Palë do të ndërmarrë hapa për të vendosur në mënyrë progresive, duke patur parasysh proceset ndërkombëtare, aty ku shihet si e përshtatshme, një sistem kombëtar të qëndrueshëm të inventareve apo regjistrave për ndotjen në një database të strukturuar, kompjuterizuar dhe të disponueshëm për publikun, të hartuar përmes raportimit të standartizuar. Një sistem i tillë mund të përfshijë inputet, çlirimet dhe transferimet e një sërë substancash dhe produktesh të specifikuar, përfshirë ujin, energjinë dhe përdorimin e burimeve, nga një sferë e specifikuar e aktiviteteve tek media mjedisore dhe tek trajtimi në vend ose jo i vendeve të depozitimit.
10. Asgjë në këtë nen nuk mund të paragjykojë të drejtën e Palëve për të refuzuar dhënien e një informacioni të caktuar mjedisor, në përputhje me nenin 4, paragrafet 3 dhe 4.

## **Neni 6**

### **PJESEMARRJA E PUBLIKUT NE VENDIMET PËR AKTIVITETE TË VEÇANTA**

1. Çdo Palë do të:
- (a) zbatojë kaluzolat e këtij neni, në lidhje me vendimet për lejimin e aktiviteteve të propozuara, sipas listës në Aneksin I.
- (b) zbatojë klauzolat e këtij neni, në përputhje me ligjin e vet ndërkombëtar, edhe për vendimet mbi aktivitetet e propozuara jo të listuara në Aneksin I, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin. Për këtë qëllim, Palët do të vendosin nëse një aktivitet i propozuar do t'u nënshtrohet kaluzolave të këtij neni.
- (c) mund të vendosë, rast pas rasti, në qoftë se parashikohet nga ligji kombëtar, për të mos zbatuar klauzolat e këtij neni për aktivitetet e propozuara, të cilat u shërbejnë qëllimeve të mbrojtjes kombëtare, në qoftë se kjo Palë mendon se një aplikim i këtij neni do të ketë ndikim negativ mbi këto qëllime.
2. Publiku i interesuar do të informohet, me lajmërim publik ose individualisht, si të shihet e përshtatshme, në procedurën e hershme të marrjes së një vendimi për mjedisin, dhe në një mënyrë të përshtatshme, efektive dhe në kohë, midis të tjerash, për:

- (a) Aktivitetin e propozuar dhe aplikimin mbi të cilën do të merret një vendim;
- (b) Natyrën e vendimeve të mundshme ose draftin e vendimit;
- (c) Autoritetin publik, përgjegjës për marrjen e vendimit
- (d) Procedurën e parashikuar, mënyrën dhe kohën kur ky informacion mund të jepet, përfshirë:
  - (i) Fillimin e procedurave;
  - (ii) Mundësitë e publikut për të marrë pjesë;
  - (iii) Kohën dhe vendin e çdo mbledhje publike, të parashikuar;
  - (iv) Adresimin tek autoriteti publik, prej të cilit mund të merret informacioni përkatës dhe ku ky informacioni depozitohet për shqyrtim nga publiku;
  - (v) Adresimin tek autoriteti publik ose çdo organ tjetër zyrtar, të cilit mund t'i drejtohen komente ose pyetje, si edhe informimi për kohën ose afatet kohore të paraqitjes së këtyre pyetjeve apo komenteve; dhe
  - (vi) Informimin për informacionin e disponueshëm mjedisor, në lidhje me aktivitetin e propozuar.
- (e) Faktin që aktiviteti i nënshtrohet një procedure kombëtare apo ndërkuftare të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Procedurat e pjesëmarrjes së publikut do të përfshijnë afatë të arsyeshme kohore, për faza të ndryshme, të cilat lejojnë kohë të mjaftueshme për të informuar publikun, në përputhje me paragrafin 2 me lart dhe për publikun për të përgatitur dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive, gjatë marrjes së vendimeve për mjedisin.

4. Çdo Palë do të parashikojë pjesëmarrjen e hershme të publikut, kur të gjithë alternativat janë të hapura dhe publiku mund të marrë pjesë në mënyrë efektive.

5. Çdo Palë, duhet, atje ku është e përshtatshme, të inkurajojë zhvilluesit perspektive për të identifikuar publikun e interesuar, për të hyrë në diskutime dhe për të dhënë informacion, në lidhje me objektivat e aplikimit të tyre, përpara se ata të bëjnë kërkesë për leje.

6. Çdo Palë do t'u kërkojë autoriteteve publike kompetente t'i japin publikut të interesuar leje për shqyrtim, kur ai e kërkon dhe kur kjo parashikohet në ligjin kombëtar, pa pagesë dhe menjëherë sapo ai të jetë i disponueshëm, të të gjithë informacionit, që lidhet me marrjen e vendimeve, referuar në këtë nen, i cili disponohet në kohën e procedurës së pjesëmarrjes së publikut, pa paragjykuar të drejtën e Palëve për të refuzuar dhënien e informacioneve të caktuara, në përputhje me nenin 4, paragrafi 3 dhe 4. Informacioni përkatës do të përfshijë, pa paragjykuar klauzolat e Nenit 4, të paktën:

- (a) Një përshkrim të vendit dhe karakteristikave fizike e teknike të aktivitetit të propozuar, përfshirë vlerësimin e mbetjeve dhe shkarkimeve që parashikohen;
- (b) Një përshkrim të efekteve të rëndësishme të një aktiviteti të propozuar në mjedis;
- (c) Një përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar dhe/ ose pakësuar efektet, përfshirë shkarkimet;

(d) Një përmbledhje jo-teknike të pikave të mësipërme

(e) Një përmbledhje të alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi, dhe

(f) Në përputhje me legjislacionin kombëtar, raportet dhe këshillat që i janë dhënë autoritetit publik në kohën kur publiku i interesuar do të informohet, sipas paragrafit 2 më lart.

7. Procedurat për pjesëmarrjen e publikut do të lejojnë publikun të paraqesë, me shkrim ose, si të jetë më e përshtatshme, në një mbledhje publike ose shqyrtim të zhvilluesit, çdo koment, informacion, analizë ose opinion, që konsiderohet i vlefshëm për aktivitetin e propozuar.

8. Çdo Palë do të sigurojë që në vendime do të merret mirë parasysh rezultati i pjesëmarrjes së publikut.

9. Çdo Palë do të sigurojë që, kur merret vendimi nga autoriteti publik, publiku do të informohet menjëherë për vendimin, në përputhje me procedurat e përshtatshme. Çdo Palë do ta bëjë të disponueshëm për publikun, tekstin e vendimit bashkë me arsyet dhe konsideratat mbi të cilat është bazuar ky vendim.

10. Çdo Palë do të sigurojë që, kur një autoritet publik rishqyrton ose rinovon të dhënat e kushtet e veprimit për një aktivitet të referuar në paragrafin 1, klauzolat e paragrafeve 2 deri në 9 të këtij neni, zbatohen mutatis mutandis dhe atje ku është e përshtatshme.

11. Çdo Palë do të zbatojë, brenda kuadrit të ligjit kombëtar dhe në shkallën më të mundshme e të përshtatshme, klauzolat e këtij neni në vendimet për lejimin ose jo të clirimit të qëllimshëm të organizmave të modifikuara gjenetikisht, në mjedis.

## **Neni 7**

### **PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PLANET, PROGRAMET DHE POLITIKAT QË KANË LIDHJE ME MJEDISIN**

Çdo Palë do të krijojë kushte të përshtatshme praktike dhe/ ose të tjera për pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve, që kanë lidhje me mjedisin, brenda një kuadri transparent dhe të ndershëm, duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm. Brenda këtij kuadri, do të zbatohen neni 6 paragrafet 3, 4, dhe 8. Publiku i cili mund të marrë pjesë, do të identifikohet nga autoriteti përkatës publik duke marrë parasysh objektivat e kësaj Konvente. Çdo Palë do të përpiqet, në shkallën që e shih të përshtatshme, për të ofruar mundësi për pjesëmarrjen e publikut në përgatitjen e politikave që lidhen me mjedisin.

## **Neni 8**

### **PJESËMARRJA E PUBLIKUT GJATË PËRGATITJES SE RREGULLOREVE EKZEKUTIVE DHE/OSE INSTRUMENTAVE TË PERGJITHSHEM LIGJOR E NORMATIVE**

Çdo Palë do të përpiqet që të promovojë pjesëmarrjen efektive të publikut në një periudhë të shtatshme dhe ndërsa alternativat janë akoma të hapura, gjatë përgatitjes prej autoriteteve

publike rregulloret ekzekutive dhe rregulla të tjera ligjore të përgjithshme e detyruese, të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm mbi mjedis. Për këtë qëllim duhet të ndërmerren këto hapa:

- (a) Duhet të fiksohen afatet kohore, të mjaftueshme për pjesmarrje efektive,
- (b) Duhet të publikohen ose të bëhen të disponueshme për publikun, projektet e rregullave ligjore,
- (c) Duhet t'i jepet publikut, mundësia për të komentuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore;

*Rezultatet e pjesmarrjes publike do të merren parasysh aq sa të jetë e mundur.*

## **Neni 9**

### **E DREJTA PËR T'JU DREJTUAR GJYKATES**

1. Çdo Palë, brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar, do të sigurojë që çdo person i cili mendon se kërkesa e tij për informacion sipas nenit 4 është nënvleftësuar, refuzuar gabimisht, pjesërisht ose tërësisht, i është përgjigjur në mënyrë të pamjaftueshme ose nuk është trajtuar në përputhje me klauzolat e këtij neni, ka të drejtë për të patur një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj. Në rrethanat kur një Palë parashikon një shqyrtim të tillë nga një gjykatë, ajo do të sigurojë që ky person të ketë gjithashtu të drejtë për një procedurë të shpejtë e efektive, të vendosur me ligj, e cila është pa pagesë ose jo e shtrenjtë për rishqyrtim prej një autoriteti publik ose nga një organ i pavarur dhe i paanshëm, përveç gjykatës.

Vendimet përfundimtare, sipas paragrafit 1 do të jetë detyruese për autoritetin publik që zotëron informacionin. Arsyet do të jepen me shkrim, të paktën për rastet kur informacioni është refuzuar, në përputhje me këtë paragraf.

2. Çdo Palë, brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar, do të sigurojë që anëtarët e publikut të interesuar që:

- (a) kanë interes të mjaftueshëm, ose
- (b) u është cënuar një e drejtë, në rast se ligji procedural i një Palë e kërkon këtë si parakusht,

do të kenë të drejtën për një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës dhe/ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj, për të mos pranuar legalitetin substantive dhe procedural të çdo vendimi, akti ose lënie mënjanë, sipas klauzolave të nenit 6 dhe, kur kjo parashikohet në ligjin kombëtar dhe pa paragjykuar paragrafin 3 më poshtë, të klauzolave të tjera përkatëse të kësaj Konvente.

Çfarë përbën interes të mjaftueshëm dhe cënim të një të drejte do të përcaktohet, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe me objektivin për t'i dhënë publikut të interesuar të drejta me të zgjeruara për t'ju drejtuar gjykatës, brenda sferes se kësaj Konvente. Për këtë qëllim, interesi i një organizate jo qeveritare që plotëson kërkesat e referuara në nenin 2,

paragrafi 5, do të konsiderohet i mjaftueshem për qellimin e nënparagrafit (a) me lart. Organizatat e tilla do të konsiderohen si organizata që kanë të drejta, të cilat u cenohen për qellimet e nënparagrafit b me lart.

Klauzolat e paragrafit 2 nuk do të përjashtojnë mundesinë e një procedure shqyrtimi paraprak përpara një autoriteti administrativ dhe nuk do të ndikojnë kerkesen e shterimit të procedurave të shqyrtimit administrativ, përpara apelimit të procedurave gjyqesore të shqyrtimit, në rastet kur një kërkesë e tille ekziston në ligjin kombëtar.

3. Perveç kësaj dhe pa paragjykuar procedurat e shqyrtimit, të referuara në paragrafet 1 dhe 2 me lart, çdo Palë do të siguroje që, në rastet kur anëtarët e publikut plotesojnë kriteret, në se ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t'ju drejtuar procedurave administrative ose gjyqesore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat private dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vet kombëtar, në lidhje me mjedisin.

4. Për më tepër dhe dhe pa paragjykuar paragrafin 1 më lart, procedurat e referuara në paragrafet 1,2, dhe 3 do të sigurojnë mjete të përshtatshme dhe efektive, përfshirë lehtësimin e vendimit gjyqësor, të cilat do të jenë të ndershme, të barabarta, në kohë dhe jo tepër të shtrenjta. Vendimet sipas këtij neni, do të jepen ose regjistrohen me shkrim. Vendimet e gjykatave dhe aty ku është e mundur, e organeve të tjera do të bëhen të disponueshme për publikun.

5. Me qëllim që të rritet efektiviteti i klauzolave të këtij neni, çdo Palë do të siguroje që publikut t'i jepet informacion për të drejtën e tij për t'ju drejtuar procedurave të shqyrtimit administrativ e gjyqësor dhe do të marrë në konsideratë krijimin e mekanizmave ndihmës të përshtatshëm, për të hequr ose pakësuar pengesat financiare ose pengesa të tjera në ushtrimin e së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës.

## **Neni 10**

### **MBLEDHJA E PALEVE**

1. Mbledhja e Parë e Palëve do të realizohet jo me vonë se një vit mbas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Mbas kësaj, një mbledhe e zakonshme e Palëve do të mbahet të paktën një herë në çdo 2 vjet, nëse nuk vendoset ndryshe nga Palët, ose në rastin e një kërkesë me shkrim të një Palë të caktuar, me kusht që brenda 6 muajve të komunikimit të kërkesës tek të gjitha Palët, nga Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Evropën (KEE). Kjo kërkesë duhet të mbështetet nga të paktën një e treta e Palëve.

2. Në mbledhjet e tyre, Palët do të mbajnë nën shqyrtim të vazhdueshëm zbatimin e kësaj Konvente, mbi bazën e një raportimi rregullisht nga të gjitha Palët dhe me këtë qëllim në mendje, do të:

(a) shqyrtojnë politikat për metodat ligjore dhe metodologjike të të drejtës për informacion, pjesëmarrjes së publikut në vendim marrje dhe të drejtës për t'ju drejtuar gjykatës në çështjet e mjedisit, me synimin për t'i përmirësuar ato;

(b) shkëmbejnë informacion, në lidhje me eksperiencën e fituar nga përfundimi dhe zbatimi i marrëveshjeve dy dhe shumë palëshe, ose praktikave të tjera që lidhen me qëllimet e kësaj Konvente, në të cilat një ose më shumë Palë janë palë;

(c) kërkojnë, aty ku është e përshtatshme, shërbimet e organeve përkatëse të KEE dhe organeve të tjera kompetente ndërkombëtare dhe komiteteve specifike, në të gjitha aspektet që lidhen me arritjen e synimeve të kësaj Konvente;

(d) krijojnë organe ndihmëse, në se ato e shohin të nevojshme;

(e) përgatisin, kur është e përshtatshme, protokollet e kësaj Konvente;

(f) marrin në konsiderate dhe miratojnë propozimet për amendamente të kësaj Konvente, në përputhje me klauzolat e nenit 14;

(g) marrin në konsideratë dhe ndërmarrin çdo veprim tjetër, që mund të kërkohet për arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente;

(h) marrin në konsideratë dhe miratojnë me konsensus, në mbledhjen e tyre të parë rregullat e procedurës për mbledhjet e tyre dhe mbledhjet e organeve ndihmëse;

(i) shqyrtojnë, në mbledhjen e tyre të parë, përvojën e tyre në zbatimin e klauzolave të nenit 5, paragrafi 9 dhe marrin në konsideratë hapat e nevojshme për të zhvilluar me tej sistemin, e referuar në atë paragraf, duke patur parasysh proceset dhe zhvillimet ndërkombëtare, përfshirë shtjellimin e një dokumenti të përshtatshëm në lidhje me regjistrat apo inventarët e shkarkimeve ndotëse dhe të transferuara, të cilat mund t'i aneksoheshin kësaj Konvente.

3. Mbledhja e Palëve mund të marrë në konsideratë, nëse e nevojshme, krijimin e procedurave financiare me konsensus.

4. Kombet e Bashkuara, agjensitë e tyre të specializuara dhe Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si edhe çdo shtet ose organizatë rajonale e integritit ekonomik, me të drejtën e nënshkrimit të kësaj Konvente, sipas nenit 7, por e cila nuk është Palë në të, dhe çdo organizatë ndërqeveritare e kualifikuar në fushat me të cilat lidhet Konventa, do të kenë të drejtën për të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e Palëve.

5. Çdo organizatë jo qeveritare, e specializuar në fushat me të cilat lidhet Konventa, e cila ka informuar Sekretarin Ekzekutiv të KEE për dëshirën e saj për t'u përfaqësuar në një mbledhje të Palëve, do të ketë të drejtën për të marrë pjesë si vëzhgues, në qoftë se të paktën një e treta e palëve e pranishme në mbledhje nuk ka kundërshtime.

## **Neni 11**

### **E DREJTA PËR TË VOTUAR**

1. Çdo Palë në këtë Konventë do të ketë të drejtën e një vote, me përjashtim të prashikimit të paragrafit 2 më poshtë.

2. Organizatat rajonale të integritit ekonomik, në çështjet brenda kompetencës së tyre do të ushtrojnë të drejtën e tyre, për të votuar me një numër votash të barabarta me numrin e vendeve anëtare, të cilat janë Palë në këtë Konventë. Organizata të tilla nuk do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar, në qoftë se vendet e tyre anëtare ushtrojnë të drejtat e tyre dhe anasjelltas.

## **Neni 12**

### **SEKRETARIATI**

Sekretari Ekzekutiv i KEE do të kryejë funksionet e mëposhtme sekretariale:

- (a) mbledhjen dhe përgatitjen e mbledhjeve të Palëve;
- (b) shpërndarjen për Palët të raporteve dhe informacioneve të tjera, të marra në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente dhe
- (c) funksione të tjera që mund të përcaktohen nga Palët.

## **Neni 13**

### **ANEKSET**

Anekset e kësaj Konvente do të përbëjnë një pjesë integrale të saj.

## **Neni 14**

### **AMENDAMENTET E KONVENTËS**

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente për këtë Konventë.
2. Teksti i çdo amendamenti të propozuar për këtë Konventë, do t'i paraqitet me shkrim Sekretarit Ekzekutiv të KEE, i cili do t'ia komunikojë atë të gjitha Palëve, të paktën 90 ditë përpara mbledhjes së Palëve, në të cilën ai është propozuar për miratim.
3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje për çdo amendament të propozuar për këtë konventë, me konsensus. Në se të gjitha përpjekjet për konsensus dështojnë dhe nuk arrihet marrëveshje, amendamenti, si mjet i fundit do të miratohet nga tre të katërtat e shumicës votuese të Palëve, që janë të pranishme dhe që votojnë në mbledhje.
4. Amendamentet për këtë Konventë të miratuara, në përputhje me paragrafin 3 më sipër, do t'u komunikohen Palëve nga Depozituesi, për t'u ratifikuar, aprovuar ose pranuar. Amendamentet për këtë Konventë, të tjera nga ato të një aneksi do të hyjnë në fuqi për Palët që i kanë ratifikuar, aprovuar ose pranuar ato në ditën e nëntëdhjetë, mbas marrjes së njoftimit prej depozituesit për ratifikimin, aprovimin ose pranimin nga të paktën tre të katërtat e këtyre Palëve. Mbas kësaj, ato do të hyjnë në fuqi për çdo Palë tjetër në ditën e nëntëdhjetë, mbasi kjo Palë depoziton dokumentat e vet të ratifikimit, aprovimit ose pranimit të këtyre amendamenteve.
5. Çdo Palë e cila nuk mund të aprovojë një amendament të një aneksi të kësaj Konvente do të njoftojë për këtë Depozituesin me shkrim brenda 12 muajve, nga data e komunikimit të miratimit. Depozituesi do të njoftojë të gjitha Palët për marrjen e një njoftimi të tillë.
6. Me skadimin e 12 muajve që nga data e komunikimit të amendamentit për një aneks të Depozituesi, sic parashikohet në paragrafin 4 më lart, ai do të bëhet efektiv për ato Palë, të cilat

nuk kanë paraqitur një njoftim depozituesit, në përputhje me klauzolat e paragrafit 5 më lart, me kusht që jo më shumë se një e treta e Palëve ta kenë paraqitur këtë njoftim.

7. Për qëllimet e këtij neni, “Palët e pranishme dhe që votojnë” nënkuptojnë Palët e pranishme që votojnë pro ose kundër.

## **Neni 15**

### **SHQYRTIMI I PAJTUESHMËRISË ME KONVENTËN**

Mbledhja e Palëve do të krijojë, me konsensus, praktika fakultative të një natyre jo konfrontuese, jo gjyqësore dhe këshilluese për të shqyrtuar pajtueshmërinë me klauzolat e kësaj Konvente. Këto praktika do të lejojnë përfshirjen e duhur të publikut dhe mund të përfshijë alternativën e shqyrtimit të komunikimeve prej anëtarëve të publikut për çështjet që lidhen me këtë Konventë.

## **Neni 16**

### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

1. Në rast se ka mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palë për interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të kërkohet një zgjidhje me anë të negociatave ose mjeteve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të pranueshme për Palët në mosmarrëveshje.

2. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo kohë pas këtyre fazave, një Palë mund t'i deklarojë me shkrim depozituesit që për një mosmarrëveshje të pazgjidhur në përputhje me paragrafin 1, ajo pranon njërën ose të dyja mjetet e mëposhtme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si të detyrueshme, në lidhje me çdo Palë që pranon të njëjtin detyrim:

(a) Paraqitja e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë

(b) Arbitrazhi, në përputhje me procedurën e vendosur në Aneksin II.

3. Në qoftë se Palët në mosmarrëveshje kanë pranuar të dyja mjetet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, referuar në paragrafin 2 më lart, mosmarrëveshja mund t'i paraqitet vetëm Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në qoftë se Palët nuk bien dakort ndryshe.



## **Neni 17**

### **NËNSHKRIMI**

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në Aarhus (Danimarkë) më 25 qershor 1998, dhe mbas kësaj date në qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, deri në 21 dhjetor 1998, prej vendeve anëtare të Komisionit Ekonomik për Evropën, si edhe shtetet që kanë status këshillues me KEE, sipas paragrafeve 8 dhe 11 të Rezolutës 36 (IV) të Këshillit Ekonomik e Social, 28 mars 1947, dhe nga organizatat rajonale të integritit ekonomik, të përbërë nga shtetet anëtare sovraane të KEE, tek të cilat shtetet anëtare i kanë transferuar kompetencën për çështjet që trajtohen nga kjo Konventë, përfshirë kompetencën për të hyrë në traktate që lidhen me këto çështje.

## **Neni 18**

### **DEPOZITUESI**

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të veprojë si Depozituesi i kësaj Konvente.

## **Neni 19**

### **RATIFIKIMI, PRANIMI, APROVIMI DHE ADERIMI**

1. Kjo Konventë do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga shtetet nënshkruese dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik.
2. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim, që prej 22 dhjetorit 1998, të shteteve dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik, referuar në nenin 17.
3. Çdo shtet tjetër, që nuk përmendet në paragrafin 2 më lart, i cili është anëtar i Kombeve të Bashkuara, mund të aderojë në Konventë, me miratimin e Mbledhjes së Palëve.
4. Çdo organizatë, e referuar në nenin 17, e cila bëhet Palë në këtë Konventë, ndërsa asnjë nga shtetet e veta anëtare nuk është Palë, do të jetë e detyruar të plotësojë të gjitha detyrimet e kësaj Konvente. Në qoftë se një ose më shumë shtete anëtare të një organizate të tillë, është Palë në këtë Konventë, organizata dhe shtetet e veta anëtare do të vendosin për përgjegjësi të tyre përkatëse, për përmbushjen e detyrimeve, sipas kësaj Konvente. Në të tilla raste, organizatat dhe shtetet anëtare nuk do të kenë të drejtën e ushtrimit të të drejtave, që rrjedhin nga kjo Konventë, paralelisht.
5. Në dokumentat e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit, organizatat rajonale të integritit ekonomik, referuar në Nenin 17, do të deklarojnë shkallën e kompetencës së tyre, në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konventë. Këto organizata do të informojnë gjithashtu edhe Depozituesin për çdo ndryshim të konsiderueshëm, në lidhje me shkallën e ushtrimit të kompetencës së tyre.

## **Neni 20**

### **HYRJA NË FUQI**

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë, mbas datës së depozitimit të dokumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit.
2. Për qëllimet e paragrafit 1 më lart, çdo dokument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik, nuk do të numërohet si suplementare e atyre dokumentave, që janë depozituar nga shtetet anëtare të një organizate të tillë.
3. Për çdo shtet ose organizatë, referuar në nenin 17 e cila ratifikon, pranon ose aprovon këtë Konventë apo aderon në të mbas depozitimit të dokumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit, Konventa hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë, mbas datës së depozitimit nga ky shtet apo organizatë të dokumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit.

## **Neni 21**

### **TËRHEQJA**

Në çdo kohë, mbas tre vjetëve nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi nga një Palë e caktuar, ajo Palë mund të tërhiqet nga Konventa, duke i dhënë njoftim me shkrim Depozituesit. Çdo tërheqje e tillë do të bëhet efektive ditën e nëntëdhjetë mbas datës së marrjes së njoftimit nga Depozituesi.

## **Neni 22**

### **TEKSTET AUTENTIKE**

Origjinali i kësaj Konvente, për të cilat tekstet në anglisht, frengjisht dhe rusisht janë autentike në menyrë të barabartë, do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Dëshmitarë të të nënshkruarve, të autorizuar siç duhet, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Përgatitur në Aarhus (Danimarkë), ditën e njëzetë e pesë të qershorit, të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë.

## Aneksi I

### **LISTA E AKTIVITETEVE, REFERUAR NË NENIN 6, PARAGRAFI 1(a)**

#### **1. SEKTORI I ENERGJISË**

- Rafineritë e naftës bruto dhe gazit natyror;
- Impiantet e gazifikimit dhe likuidifikimit;
- Stacione të energjisë termike dhe impiante të tjerë djegës me inpute nxehtësie 50 megavat ose më tepër;
- Furra koksi;
- Stacione të energjisë bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë, përfshirë braktisjen apo ndërprerjen e aktivitetit të këtyre stacioneve ose reaktorëve **1/** (përveç impianteve kërkimore për prodhimin e konvertimin e materialeve natyrore e produktive, fuqia maksimale e të cilave nuk i kalon 1kW ngarkesë të vazhdueshme termale);
- Impiante për riprodhimin e lëndës djegëse rrezatuese bërthamore;
- Impiante të projektuara për:
  - prodhimin ose padurimin e lëndëve djegëse bërthamore
  - përpunimin e lëndës djegëse rrezatuese bërthamore ose mbetjeve radioaktive nivelit të lartë
  - asgjësimin përfundimtar të lëndës djegëse rrezatuese bërthamore
  - vetëm për asgjësimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive
  - vetëm për magazinimin (planifikuar për më shumë se 10 vjet) të lëndëve djegëse rrezatuese bërthamore ose mbetjeve radioaktive në një vend tjetër nga vendi i prodhimit.

#### **2. PRODHIMI DHE PËRPUNIMI I METALEVE**

- Impiante të pjekjes ose shkrirjes së mineraleve (përfshirë mineralin e sulfidit)
- Impiante për prodhimin e gizes ose çelikut (bashkimi primar ose sekondar), përfshirë derdhjen e vazhdueshme me një kapacitet mbi 2.5 ton në orë.
- Impiantet për përpunimin e metaleve të hekurit:
  - uzina të petëzimit me kapacitet 20 ton çeliku bruto në orë
  - kovaçana me çekiç, energjia e të cilave i kalon 50 kilozhul për çekiç, ndërsa fuqia kalorifike e përdorur i kalon 20 MW
  - aplikimi i veshjeve mbrojtëse me metal të përzier me një input që i kalon 2 ton të çelikut bruto në orë
- Fonderi të metaleve të hekurit me një kapacitet prodhimi, që i kalon 20 ton në ditë.
- Impiante për:
  - Prodhimin e metaleve me ngjyra nga mineralet, koncentratet ose lëndë dytësore të proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike;
  - Shkrirjen, përfshirë përzjerjen e metaleve me ngjyrë, përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi, etj.) me një kapacitet shkrirjeje që i kalon 4 tonë në ditë për plumbin dhe kadiumin ose 20 tonë në ditë për të gjitha metalet;
- Impiantet për trajtimin sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve polastike, duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik në të cilën vëllimi i vatëve të trajtimit i kalo 30 m<sup>3</sup>

### 3. INDUSTRIA MINERALE

- Impiantet për prodhimin e çimentos në furra rrotulluese (pjekje e tharje) me një kapacitet prodhues që i kalon 500 tonë në ditë ose për prodhimin e gëlqeres në furra rrotulluese me një kapacitet prodhues që i kalon 50 ton në ditë ose në furnalta të tjera me një kapacitet prodhues që i kalon 50 tonë në ditë;
- Impiantet për prodhimin e azbestit dhe të produkteve me bazë azbesti;
- Impiantet për prodhimin e qelqit, përfshirë fibrat e xhamit me një kapacitet shkrirje, që i kalon 20 tonë në ditë;
- Impiantet për shkrijen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale me kapacitet shkrirës që i kalon 20 tonë në ditë;
- Impiantet për prodhimin e prodhimeve qeramike me anë të zjarrit, në veçanti tjegulla, tulla, tulla refraktare ose porcelani, me një kapacitet prodhues që i kalon 75 tonë në ditë dhe me një kapacitet furre që i kalon 4 m<sup>3</sup> dhe një dendësi për furrë, që i kalon 300 kg/m<sup>3</sup>.

### 4. INDUSTRIA KIMIKE

Prodhimi brenda kuptimit të kategorive të aktiviteteve, që përmban ky paragraf nënkupton prodhimin në shkallë industriale të substancave ose grupeve të substancave të listuara në nënparagrafet (a-g), me anë të proceseve kimike.

(a) Impiantet kimike për prodhimin e kimikateve organike bazë të tilla si:

- hidrokarbure të thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura ose të pangopura, alifatike ose aromatike)
- hidrokarbure që përmbajnë oksigjen, të tilla si alkole, aldehide, ketone, acide karboksilike, etere, aceton, perokside, rrëshirë
- hidrokarbure sulfurike
- hidrokarbure të azotit, të tilla si amina, amide, përbërës të azotit, përbërës të nitratit, nitrile, sianate, izocianate
- hidrokarbure që përmbajnë fosfor
- hidrokarbure halogjene
- përbërës organometalik
- materiale plastike bazë (polimere, fibra sintetike dhe fibra me bazë celuloze)
- goma sintetike
- ngjyrosës dhe pigmente
- agjentë aktiv sipërfaqësor dhe sipërfaqësues

(b) impiante kimike për prodhimin e kimikateve inorganike bazë, të tilla si:

- gaze, të tillë si amoniaku, klori ose klorur hidrogjeni, fluori ose fluor hidrogjeni, dioksidi i karbonit, përbërësit e squfurit, hidrogjeni, dioksidi i squfurit, kloruri i karbonilit
- acide, të tilla si acidi i kromit, acidi hidorfluorik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi hidroklorik, acidi sulfurik, oleumi dhe acidi sulfuror;
- bazat, të tilla si hidroksidi i amonit, hidroksidi i kaliumit, hidroksidi i natriumit;
- kripërat si kloruri i amonit, kloratet e kaliumit, karbonati i kaliumit, karbonati i natriumit, perboratet, nitrati i argjendit;
- jo metalet, oksidet e metaleve ose komponime të tjera organike si karbiti i kalçiumit, silicit, karburi i silicit;

- (c) Impiantet kimike për prodhimin e plehrave me bazë fosfatike ose fosfatike azotike (plehra të thjeshtë ose të përbërë)
- (d) Impiantet kimike për prodhimin e produkteve me bazë bimore shëndetsore dhe të biocideve
- (e) Impiantet që përdorin proceset kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve me bazë farmaceutike
- (f) Impiantet kimike për prodhimin e lëndëve shpërthyese
- (g) Impiantet kimike që prodhojnë shtesa ushqimore proteinike, fermente dhe substanca të tjera proteinike me rrugë kimike ose biologjike.

## **5. ADMINISTRIMI I MBETURINAVE**

- Impiantet për djegjen, rikuperim, trajtim kimik ose groposje të mbeturinave të rrezikshme;
- Impiante për djegjen e mbeturinave urbane me kapacitet më të madh se 3 ton/orë;
- Impiantet për depozitimin e mbeturinave jo të rrezikshme me kapacitet më të madh se 50 ton/ditë
- Fusha groposje që zënë jo më shumë se 10 ton/ditë ose me një kapacitet total më të madh se 25000 ton, duke përjashtuar fushat e griposjes së mbeturinave inerte.

## **6. IMPIANTET E TRAJTIMIT TË SHKARKIMEVE TË LENGTA URBANE ME KAPACITET MË TË MADH SE 150000 EKUIVALENT BANORË.**

## **7. IMPIANTE INDUSTRIALE PËR :**

- (a) Prodhimi i pulpës nga lëndët drusore ose fibrave të tjera të ngjashme
- (b) Prodhimi i letrës dhe kartonave me kapacitet prodhues më të madh se 20 ton /ditë

- 8.**
- (a) Ndërtimi i linjave për trafikun hekurudhor në distancë të gjatë dhe për aeroporte 2/ me rrugë kalimi bazë më të madhe ose të barabartë se 2100m;
  - (b) Ndërtimi i autostradave dhe i autostradave të shpejta 3/
  - (c) Ndërtimi i një rruge të re me katër ose me shumë korsi, ose rirjeshtimi ose zgjerimi i një rruge egzistuese me dy ose më pak korsi kur do të sigurohen 4 ose më shumë korsi, ku kjo rrugë e re ose seksioni i rrjeshtuar dhe/ose i zgjeruar i rruges duhet të jetë 10 km ose më shumë në vazhdimësi.

- 9.**
- a) rrugët e kalimit të ujërave të brendshme dhe portet për trafikun e rrugëve të kalimit të ujërave të brendshëm që lejon kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 ton;
  - b) portet e tregëtimit, molot për ngarkim shkarkim të lidhura me tokën ose porte të jashtëm(duke përjashtuar molot hekurudhore) të cilat mund të marrin anije me tonazh më të madh se 1350 ton.

- 10. EKSTRAKTIMI I UJËRAVE NËNTOKËSORE** ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntoksore, ku vëllimi vjetor i ujit të tërhequr ose të rimbushur(ringarkuar) është i barabartë ose më i madh se 10 milion metër kub.

**11.** a) Punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve, ku transferimi synon, tek rrugëkalimet e shkurtra parandaluese të ujërave dhe ku sasia e ujërave të transferuar është më e madhe se 100 milion metër kub/vit;

b) në të gjitha rastet, punimet për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve ku rrjedha shumë vjetore e basenit të ekstraktimit është më e madhe se 2000 milion metër kub/vit dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 5% e kësaj rrjedhje.

Në të dy rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshem me tubacione.

**12. EKSTRAKTIMI I NAFTËS DHE GAZIT NATYROR** për qëllime tregëtimi ku sasia e ekstraktuar është më e lartë se 500 ton/ditë për naftën dhe 500000 metër kub/ditë për gazin natyror.

**13. DIGAT DHE IMPIANTET E TJERA TË PROJEKTUARA** për mbajtjen ose depozitimin e ujit ku një sasi shtesë e ujit, është më e madhe se 10 milion metër kub.

**14. TUBACIONET PËR TRANSPORTIN E GAZIT, PRODUKTEVE TË NAFTES OSE KIMIKATEVE** me diametër më të madh se 800 mm dhe një gjatësi më të madhe se 40 km.

**15. IMPIANTET PËR RRRITJEN INTENSIVE TË SHPENDEVE DHE DERRAVE** që kanë më shumë se:

- a) 40 000 vende për kafshë
- b) 2000 vende për prodhim derrash (mbi 30 kg);or
- c) 750 vende për farërat

**16. GURORET DHE MINIERAT E HAPURA TË ARGJILAVE** ku sipërfaqja e vendit është më e lartë se 25 hektarë, ose ekstraktimi i torfës, ku sipërfaqja e vendit është më e madhe se 150 hektarë.

**17. NDËRTIMI I LINJAVE ELEKTRIKE TË TENSIONIT TË LARTË,** me një voltazh 220 kv ose me një gjatësi më të madhe se 15 km.

**18. AKTIVITETET E TJERA:**

- Impiantet për trajtimin paraprak (operacione të tilla si larja, zbardhja, mercerizimi) ose ngjyrosjen e fibrave ose tekstileve, ku kapaciteti i trajtimit është më i lartë se 10 ton/ditë;

- Impiantet për trajtimin e lëkurëve, ku kapaciteti i trajtimit është më i madh se 12 ton të produktit të përfutur/ditë;

a) Ujërat e zeza shtëpiake me kapacitet të kërkesës se prodhimit, më të madh se 50 ton/ditë

b) Trajtimi dhe përpunimi i synuar për prodhimin e produkteve ushqimore nga:

- Lëndët e para me origjinë shtazore (e tjerë përvec qumështit) me kapacitet të prodhimit të produktit të gatshëm më të madh se 75 ton/ditë.
- Lëndët e para bimore me kapacitet të prodhimit të produktit përfundimtar më të madh se 300 ton në ditë (vlera mesatare mbi bazë një të katërtën)

c) Trajtimi dhe përpunimi i qumështit, sasia e qumështit të përftuar që është më e madhe se 200 ton në ditë( vlera mesatare mbi bazë vjetore)

- Impianti për depozitimin ose riqarkullimin e mbeturinave të kafshëve dhe karkasave të kafshëve, me kapacitet trajtimi me të madh 10 ton në ditë;
- Impianti për trajtimin sipërfaqësor të substancave, objekteve ose produkteve që përdorin solventë organikë, në veçanti për veshje, printim, mbiveshje, çyndyrësim, kundër depërtimit të ujit, bojërave, pastrim ose njeshje, me një kapacitet harxhimi me të madh se 150 kg/orë ose më të madh se 200 ton/vit.

**20.** Çdo aktivitet që nuk mbulohet nga paragrafët 1-19 më sipër ku pjesëmarrja e publikut sigurohet nga procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

**21.** Klauzola e nenit 6, paparagrafi 1 (a) i kësaj konvente, nuk zbatohet për ndonjë projekt të mësipërm të ndërmarrë në mënyrë ekskluzive ose kryesisht për kërkim shkencor, zhvillimi dhe testimi i metodave të reja ose produkteve për më pak se dy vjet, po qe se ka të ngjarë që ata do të shkaktojnë efekt të rëndësishëm negativ në mjedis.

**22.** Çdo ndryshim për zgjerim aktivitetesh, ku një ndryshim ose zgjerim i tillë në vetvete, përmbush kriteret/kufijtë e vënë në këtë aneks, do të jetë subjekt i nenit 6, paragrafi 1(a) i kësaj konvente. Çdo ndryshim tjetër ose zgjerim i aktivitetit duhet të jetë subjekt i nenit 6, paragrafi 1(b) i kësaj konvente.

### Shënime:

1/ Stacione të energjisë bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë pushojnë se funksionuari si impiante të tilla, kur lëndët djegëse dhe elementët e tjerë të ndotur radioaktivë janë hequr përfundimisht prej vendndodhjes së impiantit.

2/ Për qëllimet e kësaj Konvente, “aeroport” nënkupton një aeroport i cili është në pajtim me përkufizimin e Konventës së Cikagos të 1994, e cila vendos krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (Aneksi 14).

3/ Për qëllimet e kësaj Konvente, “autostradë e shpejtë” nënkupton një rrugë në pajtim me përkufizimin në Marrëveshjen Evropiane për Arteriet e trafikut Ndërkombëtar të 15 nëntorit 1975.